



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Tiranë, më 11.3.2019

Lënda: Parashtrimet e Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 11.3.2019, për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Brati, konfirmuar në detyrë me anë të vendimit nr. 32/2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja dhe zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit!

Mbi bazën e shkaqeve të ankimit, të ngritura nga Komisioneri Publik, ndaj vendimit nr. 32/2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në konsideratë të prapësimeve dhe akteve të depozituara nga ana e subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin F, pika 3 e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 45, të ligjit nr. 84/2016, në seancën gjyqësore të datës 18.12.2018, lidhur me gjykimin e kësaj çështjeje, ndër të tjera vendosët:

- i. Të administroni deklaratën e të ardhurave, ku tregohet mbajtja e detyrimeve tatimore për personat e tjerë të lidhur për shtetasit ***.*** dhe ***.*** nga autoritetet tatimore italiane.
- ii. Të kërkonti pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës saktësimin e informacionit lidhur me derdhjet e tatimeve të të ndjerit, babait të subjektit të rivlerësimit për periudhën 1999-2003.
- iii. Të kërkonti pranë ZVRPP-së Durrës lidhur me administrimin e praktikës së plotë për rivlerësimin dhe regjistrimin e pasurisë, shtëpi + truall të subjektit të rivlerësimit në Durrës.

Në seancën e kaluar të datës 5.2.2019, pasi u administruan përgjigjet e ardhura nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, seanca u shty për datën e sotme, me shkakun se provat e kërkuara nga autoritetet italiane ende nuk kishin ardhur, e në këto kushte për ekonomi gjyqësore, subjektit të rivlerësimit, në vullnetin e saj iu la mundësia e paraqitjes së këtyre akteve lidhur me personat e tjerë të lidhur.

Gjatë kësaj kohe, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 27.2.2019, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar disa akte, si:

- i. Dokumentacion nga autoritetet italiane (Agenzia delle Entrate) lidhur me detyrimet tatimore të derdhura nga znj. ***.***, për periudhën 2010-2016;
- ii. Shkresë e nënshkruar nga Përmbaruesi Shtetëror italian, e datës ***.2.2019, që vërteton faktin se znj. *** nuk ka asnjë detyrim ndaj shtetit dhe as të tretëve.

Në aspektin formal nuk kemi ndonjë kundërshti mbi këtë dokumentacion. Ai paraqitet i përkthyer, i noterizuar, si dhe me vulë apostile.

Përpara se të vijojmë me vlerësimin e këtyre akteve në raport me shkakun e ankimit, dëshiroj të rikujtoj edhe njëherë Trupën e Nderuar, se për burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë apartament në Tiranë, në pronësi të subjektit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka adresuar nevojën për kontrollin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së: (i) huas prej 25.000 euro, marrë nga subjekti prej znj. ***,** (tezes së saj) dhe (ii) shlyerjen e kësaj huaje me anë të shumës 1.8 milionë lekë, dhuruar subjektit nga znj. ***,** (e ëma e saj).

Ky kërkim erdhi si rezultat, pasi Komisioneri Publik vlerësoi se hetimi administrativ i Komisionit ka munguar dhe nuk mund të konsiderohet i plotë sikurse ka konkluduar Komisioni se huadhënësja znj. ***,** ka pasur mundësitë financiare për dhënien e kësaj huaje, pasi ka pasur ose ka llogari bankare. Sikundër dhe për shumën e dhuruar prej 1.8 milionë lekësh nga e ëma e subjektit, dhurim i cili është deklaruar se ka shërbyer për shlyerjen e huas.

Në deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar se huaja e sipërcituar është shlyer plotësisht, por pa e shoqëruar me dokumentacion provues. Për këtë arsye, gjatë hetimit administrativ të Komisionit, subjekti ka depozituar një deklaratë noteriale të znj. ***,**, të datës ***.02.2018¹, ku deklarohet marrëdhënia e huas, formalizuar me deklaratën noteriale të shkurtit 2016 dhe se subjekti i rivlerësimit e ka shlyer plotësisht këtë hua në muajin gusht të vitit 2016².

Megjithëse gjatë hetimit administrativ të Komisionit, sikurse deklarohet nga subjekti dhe provohet nga aktet e administruara për këtë qëllim, konfirmohet fakti se në cilësinë e huadhënëses paraqitet **vetëm** znj. ***,**, gjatë shqyrtimit të çështjes pranë Kolegjit, subjekti i rivlerësimit, si burim të ligjshëm të huas, në referim të nenit 32/4, të ligjit nr. 84/2016, deklaroi dhe përfshin edhe të ardhurat e znj. ***,** dhe ***,**, përkatësisht djali i tezes-huadhënëses, dhe bashkëshortja e tij. Kështu, në seancën e datës 13.12.2018, subjekti, përveç prapësimeve, vuri në dispozicion disa akte, si vërtetim mbi të ardhurat e përgjithshme për znj. ***,** dhe z. ***,**, lëshuar nga zyra territoriale e qytetit të ***, Itali, për vitet 2000-2017³, si dhe dy kartat e identitetit, të lëshuara nga Republika e Italisë për këta dy persona.

Në këto rrethana, kur deklarimi mbi burimin ndryshoi, Komisioneri Publik vlerësoi dhe kërkoi se:

- i. Provat e administruara nuk hedhin dritë nëse për huan prej 25.000 euro, si burim i ligjshëm kanë shërbyer vetëm të ardhurat nga djali i tezes dhe i bashkëshortes së tij, nga puna e tyre në shtetin italian apo si burim përfshihen edhe të ardhurat e znj. ***,**, ku kjo e fundit deklarohet dhe konfirmohet si huadhënësja! Është e nevojshme që subjekti të specifikojë shumën respektive dhe burimin e ligjshëm. Kujtojmë se marrja e huas është kryer nëpërmjet sistemit bankar pranë ***, por për këtë shumë nuk rezultoi ndonjë transfertë nga shteti italian në Shqipëri apo derdheje në këtë llogari nga këta persona. Konstatohet se në këtë llogari dyemërore të znj. ***,** dhe znj. ***,**, pranë ***, janë derdhur në

¹ Nr.*** rep. dhe nr.*** kol., redaktuar nga noteri i Dhomës Noteriale Vlorë, znj. ***,**.

² Për shlyerjen e huasë, referuar deklaratës vjetore të pasurisë 2016 dhe asaj “Vetting”, subjekti deklaroi kursimet e saj të viteve 2014-2016, në shumën 1.700.000 lekë dhe shumën e dhuruar prej së ëmës, në vlerën 1.800.000 lekë.

³ Me shënimin “ky dokument nuk mund të nxirret për organet e administratës publike ose për menaxherët privatë...”, ky dokument nuk përmban informacion mbi taksat e paguara në shtetin italian.

mënyrë periodike shuma të caktuara nga persona të ndryshëm, veprime të cilat në disa raste kanë përshkrimin “*derdhje detyrimi*” dhe në disa raste kanë përshkrimin “*detyrim për qira*”.

- ii. Nëse burimi i ligjshëm i huas janë vetëm të ardhurat nga puna e znj. ***.*** dhe z. ***.***, në referencë të kërkesave të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32/5, të ligjit nr. 84/2016, të administrohet dokumentacioni i nevojshëm mbi të ardhurat mujore dhe pagimi i detyrimeve tatimore, njohur ndryshe si Modeli 730/2018.

Sikurse parashtroam edhe më sipër, në vijim të riçeljes së hetimit nga ana e Kolegjit, subjekti ka dorëzuar disa akte nga autoritetet italiane lidhur me detyrimet tatimore vetëm për znj. ***.***, për periudhën 2010-2016.

Bazuar në nenin D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, analiza jonë është fokusuar vetëm në të ardhurat për të cilat vërtetohet se janë paguar detyrimet tatimore. Si rrjedhojë, në analizë të këtyre akteve, konkretisht vërtetim mbi të ardhurat e përgjithshme, lëshuar nga Agjencia e të Ardhurave, Drejtoria Krahinore në ***, rezulton se personi tjetër i lidhur znj. ***.*** nuk ka pasur mundësi kursimi të shumës prej 25.000 euro, dhënë hua në vitin 2015.

Theksojmë se të dhënat e administruara nuk mundësojnë një analizë të plotë mbi të ardhurat familjare, pasi subjekti i rivlerësimit ka sjellë dokumente zyrtare, ku vërtetohen pagesat e detyrimeve fiskale vetëm për periudhën 2010 – 2016, për znj. ***.*** dhe nuk ka të dhëna zyrtare për pagimin e detyrimeve tatimore edhe për z. ***.***. Gjithashtu, shpenzimet vjetore jetike janë përlogaritur për një familje me përbërje dy persona, bazuar në të dhënat e publikuara nga ISTAT-Itali, ndërsa familja e ***.*** përbëhet nga tre persona.

Në formë tabelare kemi paraqitur në vijim të ardhurat dhe kursimet që mund të realizonte znj. *** për vitet 2010-2015.

.	Viti	Të ardhura vjetore bruto/euro	Tatimi neto (pa përfshirë taksat lokale)	Të ardhura neto vjetore euro	Shpenzime vjetore jetike/familje dy persona	Diferenca e mbetur/kursim euro
Të ardhura si person fizik	2010 ⁴	16.137	1.649	14.488	11.904	2.584
Të ardhura si person fizik	2011 ⁵	17.697	2.163	15.534	12.132	3.402
Të ardhura nga punësimi MOD 730-3	2012 ⁶	15.083	1.412	13.671	11.891	1.780
Të ardhura nga punësimi MOD 730-3	2013 ⁷	16.834	1.830	15.004	11.670	3.334
Të ardhura nga punësimi (dy deklarata)	2014 ⁸	10.810	1.713	9.097	12.503	0
Të ardhura nga punësimi (shtatë muaj)	2015 ⁹	8.993	902	8.092	7.357	735
Shuma		85.554	9.669	75.885	67.456	11.835

⁴ Referuar https://www.istat.it/it/files//2011/07/povert%C3%A0_15_7_2010.pdf;

⁵ Referuar <https://www.istat.it/it/files//2012/07/Poverta2011.pdf>;

⁶ <https://www.istat.it/it/files//2013/07/povert%C3%A0-2013-def.pdf>;

⁷ Referuar https://www.istat.it/it/files/2014/07/pov_2013_finale.pdf;

⁸ https://www.istat.it/it/files/2015/07/Povertà_2014.pdf;

⁹ https://www.istat.it/it/files//2016/07/La-povertà-in-Italia_2015.pdf.

Lidhur me burimin e ligjshëm të shumës së dhuruar nga znj. *.***, prej 1.8 milionë lekë, e cila së bashku me shumën 1.7 milionë lekë, të deklaruara si kursime nga subjekti, ka shërbyer për shlyerjen e huas.**

Komisioneri Publik, ndryshe nga përfundimet e Komisionit, se burimi i ligjshëm i shumës së dhuruar konfirmohet nga fakti se: *“në vitin 2006 ... nëna e subjektit të rivlerësimit kishte të ardhura në bankë në vlerën 12.000 euro, vlerë e përafërt me shumën e dhuruar...¹⁰”*, ndërkohë që konstatohet se kjo shumë është tërhequr dhe mbyllur si llogari bankare në maj të vitit 2006, ndërsa shlyerja e huas ndaj znj. ***.*** është kryer pas 10 vitesh, në konsideratë të prapësimeve dhe provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor¹¹, vlerëson se për shumën e dhuruar nuk provohet burimi i ligjshëm për krijimin dhe kursimin e saj.

Në referencë të kërkesave të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, pikat 1 dhe 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, nga analiza financiare rezulton se mundësia e kursimit nga burime të ligjshme e familjes Brati është në shumën 1.577.173 lekë (analiza është kryer deri në vitin 2002, vite për të cilat pretendohet krijimi i kursimeve). Analiza paraqitet në formë tabelare në aneksin 1, bashkëlidhur këtyre parashtrimeve.

Sikundër dhe Komisioni e ka konstatuar¹², nga kjo analizë rezulton gjithashtu se pretendimi i subjektit, se burimi i shumës së dhuruar rrjedh nga shuma prej 4 milionë lekë, dhënë hua nga familja e saj te shtetasi ***.*** dhe ky i fundit e ka kthyer atë gjatë periudhës 2011-2013, nuk provohet dhe nuk qëndron.

Në lidhje me truallin + shtëpi banimi në Durrës

Veç faktit se subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting” nuk ka deklaruar vlerën reale të kësaj pasurie, vlerësuar në datë ***.9.2013 për çmimin 18.025.520 lekë, nga praktika e përcjellë nga ZVRPP-ja Durrës për Kolegjin, konstatojmë se subjekti i rivlerësimit ka paguar taksën e rivlerësimit të banesës në shumën 160.755 lekë. Kjo shumë thëllon rezultatin negativ të subjektit për vitin 2013, ku nga analiza financiare rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën totale prej 828.760 lekë.

Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga detyrimi ushqimor, në shumën 3.100.000 lekë, dhënë nga z. *.***.**

Komisioneri Publik e ngriti si shkak ankimi, pasi kjo ndikonte në saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklaramit, lidhur kjo me analizën financiare të subjektit të rivlerësimit për vitet 2013-2014 dhe

¹⁰ Fq.16 e vendimit.

¹¹ Në parashtrimet e datës 13.12.2018, pranë KPA-së, subjekti ka vënë në dispozicion disa prova, si: Shkresën nr. *** , datë ***.11.2018, e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër; Shkresën nr. *** prot., datë ***.11.2018, e Prokurorisë së Përgjithshme; Shkresën nr. *** prot., datë ***.10.2018, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër; Shkresën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Ndërkohë për të ardhurat e nënës, subjekti ka paraqitur shkresën nr. *** prot., datë ***.10.2018 të ISSh-së, Drejtoria Rajonale Shkodër për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe pagën mesatare neto për periudhën 1987-1999.

¹² Në faqen 16 të vendimit të Komisionit, pasi është hetuar mbi të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën 1999-2002 për familjen e subjektit, në përfundim, Komisioni arsyeton se: *“nuk vërtetohet me dokument burimi i ligjshëm për shumën 4.000.000 lekë në pronësi të ***.*** dhe ***.*** (prindërit e subjektit), pavarësisht deklaratës noteriale të nënshkruar nga z. ***.***. Kjo deklaratë mund të vërtetohet shlyerjen e huas... por jo lëvrimin real të të hollave. Gjithashtu, nuk u provua me dokumentacion as ekzistenca e kësaj shume prej 4.000.000 lekë.*

2015, periudhë që përkon me krijimin e likuiditeteve të subjektit në vlerën 1.7 milionë lekë dhe fitimit të pasurisë së luajtshme, makinë e tipit “Mazda”.

Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë provë të re mbi këtë shkak të ankimit, për justifikimin e burimit të ligjshëm të këtyre të ardhurave.

KOMISIONERI PUBLIK

Darjel SINA

Aneksi 1. Analiza financiare mbi të ardhurat e ligjshme të familjes Brati dhe mundësia e kursimit, periudha 1968-2002

Nr.	Të ardhurat e ***.*** për periudhën 1968 -1993	Paga mujore	Shuma/lekë
	1.3.1968 – 15.7.1975	720	54.360
	15.7.1975 – 1.7.1976	890	10.235
	1.7.1976 – 16.2.1983	920	73.140
	13.2.1983 – 1.3.1993	1.020	12.750
1.	Shuma e të ardhurave nga i ati		150.485
	Të ardhura nga pagat e nënës 1987 - 1999		
	1987 -1988		14.640
	1989 - 1991		22.560
	1992 - 1993		36.012
	Dt.1.1.1994 – dt. 30.6.1999		533.165
	Janar, shkurt, qershor 1999 (paguar me raport)		14.183
2.	Shuma e të ardhurave nga nëna		620.560
3.	Të ardhurat nga pagat, familja Brati (1968 -1999)	(1+2)	771.045
4.	Shpenzime jetese për periudhën (1968 - 1999) 50%		385.523
5.	Diferenca midis të ardhurave të ligjshme dhe shpenzimeve 1968 -1999	(3 - 4)	385.523
6.	Të ardhura nga biznesi i të atit 1999-2002 (fitimi)		2.646.650
7.	Shpenzime jetese (sipas KPK-së 1999-2002)		480.000
8.	Paguar 1/2 pjesë takuese e shtëpisë në Durrës		975.000
9.	Diferenca në fund të periudhës 1999-2002	(6-7-9)	1.191.650
10.	Diferenca midis të ardhurave të ligjshme dhe shpenzimeve 1968-2002¹³	(9+5)	1.577.173

¹³ Në analizë janë marrë në konsideratë: Të ardhurat nga puna e të atit për periudhën 1968 – 1995; Për periudhën 1997 – 1998, vertetimi i sjellë nga subjekti me nr. *** prot., datë ***.12.2018, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk ka informacion mbi të ardhurat e përfituara dhe nëse për to janë paguar detyrimet tatimore; Të ardhura nga biznesi i z. ***.*** për periudhën 1999 – 2002; Të ardhura nga puna dhe pagat e nënës për periudhën 1987 – 1999; Shpenzimet e jetesës janë konsideruar sipas shpenzimeve të llogaritura nga KPK-ja dhe shpenzimet e kryera për pagesën e ½ pjesë takuese të shtëpisë në Durrës.